



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVIL DHE STREHIMIT

Nr. 3048.Prot

Gramsh, më 21/07/2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR
EMERGJENCAT CIVILE NË BASHKINË GRAMSH

I /të nderuar **Kryetar/anëtarë** të Këshillit bashkiak

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 414 datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, si dhe në bazë të shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me nr. prot. 429/6, datë 15.04.2026, Bashkisë Gramsh i është akorduar një fond i kushtëzuar në vlerën 9,342,128 (nëntë milion e treqind e dyzet e dy mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë, me kod produkti 21AD502 “Rehabilitimi i objekteve të ndryshme infrastrukture”.

Ky fond është akorduar me destinacion të përcaktuar dhe do të përdoret për financimin e ndërhyrjeve prioritare në infrastrukturën publike të dëmtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, me qëllim rikthimin e funksionalitetit të objekteve dhe garantimin e sigurisë së qytetarëve.

Pas verifikimeve në terren dhe vlerësimit të nevojave prioritare, propozohet që fondi të shpërndahet sipas këtyre objekteve:

- 1-Mbrojtje Lumore në luginën e Gribës me vlerën 4.000.000 lekë me TVSH.
- 2-Ndërhyrje me tombina në përroin e Shelcanit dhe përroin e Frashërit me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.
- 3-Rikonstruksion i urës në segmentin rrugor Dufshan-Sult me vlerën 1.100.000 lekë me TVSH.
- 4-Rikonstruksion i urës në fshatin Galigat me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.
- 5-Rikonstruksion i urës në Dumberas me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

6-Rikonstrukcion i dy urave të këmbësorëve në fshatin Kukur me vlerën 600.000 lekë me TVSH.

Për sa më sipër, lutemi për miratimin e kësaj mënyre përdorimi të Fondit të Mbrojtjes Civile, me qëllim realizimin e ndërhyrjeve prioritare në objektet infrastrukturore të Bashkisë Gramsh.

Ju ftoj, të nderuar këshilltarë, që pas shqyrtimit nga ana Juaj, të miratoni projektvendimin e propozuar.

Duke Ju falenderuar ,

MIRATOHET

P/Sektori

Ejona BLOSHMI

KRYETARI

Besion AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI I KËSHILLIT

Nr. 308/1 Prot

Gramsh më 22.07.2026

PROJEKT – VENDIM

PËR

“Për ndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile, për bashkinë Gramsh, për vitin 2026”.

Në mbështetje të: ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 65 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr. 414 datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”; VKB Nr. 105 datë 29.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor të Bashkisë Gramsh, për vitin 2026” si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit;

VENDOSI:

1.Miratimin e shpërndarjes së fondit të kushtëzuar në shumën 9,342,128 (nëntë milion e treqind e dyzet e dy mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë, me kod produkti 21AD502 “Rehabilitimi i objekteve të ndryshme infrastrukturore”, akorduar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, si më poshtë

-Mbrojtje Lumore në luginën e Gribës me vlerën 4.000.000 lekë me TVSH.

-Ndërhyrje me tombina në përroin e Shelcanit dhe perroin e Frashërit me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i urës në segmentin rrugor Dufshan-Sult me vlerën 1.100.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i urës në fshatin Galigat me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i urës në Dumberas me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i dy urave të këmbësorëve në fshatin Kukur me vlerën 600.000 lekë me TVSH.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Sektori I Emergjencave Civile dhe Strehimit, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës

3. Ky vendim Hyn në Fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Enis ZANI



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK GRAMSH
SEKRETARI I KËSHILLIT**

Nr 3059 prot.

Gramsh, më 22/07 /2026

THIRRJE PËR MBLEDHJE

Drejtuar :Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile .

Për Dijeni: Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Sektori i Emergjencave Civil dhe Strehimit.

Ditën e Enjte datë 23 /07 /2026 ora 10:30 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2019 neni 54 gërma (a) neni 33 , neni 34 , neni 36 i Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë , zhvillohet mbledhja e komisionit për të diskutuar relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Sektori i Emergjencave Civil dhe Strehimit:

- 1- Për miratimin e shpërndarjes së fondit të kushtëzuar për Emergjencat Civile në bashkinë Gramsh.

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

XHULIA GJINI